



Kosovo Women's Network

Serving, Protecting and Promoting the Rights of Women and Girls

STATUTI I RRJETIT TË GRAVE TË KOSOVËS

Ky statut do të qeverisë shoqatën jofitimprurëse Rrjeti i Grave të Kosovës, të themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Neni 1

Emri, forma dhe adresa

1.1. Organizata do të quhet Rrjeti i Grave të Kosovës.

1.2. Ajo mund të njihet edhe si RrGK.

1.3. Organizata është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr.

04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

1.4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin/en nga themeluesit/et, drejtorin/en, nëpunësit/et, ndonjë anëtar/e të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për këtë organizatë.

1.5. Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të Bordit ose punonjësve të saj ndalohet, përveç, nëse organi drejtues vendos, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për OJQ-në, dhe se OJQ-ja nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.

1.6. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në Rruga Kadri Gjata (ish Feriz Blakçori), kati II, nr.8, 10000, Prishtinë, Kosovë.

1.7. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me paragrafin 1.4 të këtij Statuti dhe nenin 4 të Ligjit për Lirim të Asociimit në OJQ 04/L-57, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.

Neni 2

Themeluesit

2.1. Themelues të organizatës janë:

Igballe Rogova, Prishtinë

Luljeta Vuniqi, Prishtinë

Arjeta Rexha, Prishtinë

2.2. Kuvendi i Anëtarëve vendos për përfaqësuesin/en e autorizuar të OJQ-së, i/e cili/a përfaqëson organizatën dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ai/ajo është përgjegjës për informimin e autoriteteve kompetente për çfarëdo ndryshimi në të dhënat e deklaruar në rastin e regjistrimit të organizatës

Neni 3

Qëllimi

3.1. Qëllimi i RrGK është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në të gjithë Kosovën, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, fetare, etnike, mosha, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësia. RrGK e realizon këtë qëllim përmes shkëmbimit të përvojës dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe shërbimeve. Më detajisht, objektivat e RrGK janë:

- Të sigurojë pjesëmarrjen e barabartë, aktive dhe efektive të grave dhe të vajzave në zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Kosovë;
- Të avokojë për të drejtat e grave dhe vajzave në të gjitha sferat e jetës;
- Të fuqizojë lëvizjen e grave dhe vajzave në Kosovë përmes solidaritetit dhe përkrahjes reciproke;
- Të realizojë përfshirjen e grupeve të grave të Kosovës në iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e promovimit të të drejtave të grave dhe vajzave.

3.2. Për t'i përmbushur qëllimet e saj, RrGK do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në këto aktivitete të poshtëshënuara:

- Do të identifikojë brengat dhe problemet e përbashkëta dhe individuale të shoqatave anëtare të saj;
- Do të ofrojë informata dhe asistencë teknike për shoqatat e anëtare të saj;
- Do të organizojë fushata të përbashkëta informimi, edukimi dhe avokimi lidhur me çështje të rëndësishme të të drejtave të grave në Kosovë;

- Do të angazhohet në krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit mes RrGK dhe Parlamentit, Qeverisë dhe Ministrive të Kosovës me qëllim të transmetimit të brengave dhe propozimeve të grave dhe vajzave të Kosovës. Këto marrëdhënie do të realizohen përmes kontakteve, raporteve, paraqitjeve publike, si dhe me metoda të tjera;
- Do të angazhohet në media, diskutime publike, si dhe mjete tjera të përshtatshme me qëllim të ngritjes së vetëdijes institucionale dhe publike lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në të gjitha sferat e jetës;
- Do të angazhohet në krijimin e një klime të favorshme publike dhe institucionale për realizimin e të gjitha të drejtave të grave dhe vajzave;
- Do të mbledhë, analizojë dhe ndajë informata lidhur me ligjet dhe rregulloret e institucioneve të Republikës së Kosovës që janë të rëndësishme për gratë dhe vajzat.

Neni 4

Anëtarësimi

4.1. Anëtarësimi në RrGK është i hapur për çdo person pavarësisht prej racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Kuvendi dhe Bordi i RrGK-së. Për t'u anëtarësuar në RrGK, secili/a i/e interesuar duhet të pranojë Statutin dhe Misionin e RrGK-së dhe të angazhohet për përmbushjen e qëllimeve të RrGK-së.

4.2. Kuvendi i Anëtarëve do të vendosë nëse do të kërkohet pagesa e anëtarimit nga anëtarët. Në rast të vendosjes së pagesës së anëtarësimin, Kuvendi do të vendosë për rregullat dhe procedurat e pagesës së anëtarësimin, përfshirë marrjen e masave të ndryshme, të cilat specifikohen në rregulloren e anëtarësisë.

4.3. Anëtarësimi i ndonjë anëtari/eje gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e

Kuvendit të Anëtarëve në rast se:

- Shoqata anëtare pushon së ekzistuari;
- Anëtari/ja heq dorë vullnetarisht nga anëtarësia në RrGK;
- Anëtari/ja përjashtohet me vendim të Bordit të RrGK në rastet kur ka shkelje të rënda të Statutit, të rregulloreve të brendshme të RrGK ose të vendimeve të shoqatës.

Në rast të suspendimit, do të përcaktohet kohëzgjatja e suspendimit.

4.4. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me dy të tretat (2/3) e anëtarëve.

Neni 5

Kuvendi i Anëtarëve

5.1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve, respektivisht organizatave të përfaqësuara nga përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

5.2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës. Në këtë kuadër, Kuvendi i Anëtarëve ka kompetencë të zgjedhë dhe të shkarkojë zyrtarët në pozita udhëheqëse të OJQ-së, të aprovojë raportet periodike financiare dhe të punës, të interpretojë dhe ndryshojë Statutin, si dhe të vendosë për bashkimin, ndarjen apo shuarjen e OJQ-së. Këto përgjegjësi duhet të votohen nga dy të tretat (2/3) e Kuvendit të Anëtarësisë dhe nuk mund të delegohen në organet tjera më të ulta.

5.3. Përpos përgjegjësi të rezervuara që ka Kuvendi i Anëtarëve sipas statutit, ai gjithashtu ka edhe këto përgjegjësi:

Miraton Statutin e shoqatës, ndryshimet e tij dhe vendos për shpërndarjen e RrGK;

- Zgjedh dhe shkarkon antarët e Bordit të RrGK;
- Përcakton strategjinë e punës vjetore të RrGK;
- Aprovon buxhetin vjetor të RrGK;
- Pranon dhe miraton raportin vjetor mbi punën dhe raportin vjetor financiar të RrGK;
- Cakton masën e kuotës së anëtarësisë që duhet ta paguajnë anëtarët;
- Vendosë edhe për çështje tjera të rëndësishme për punën dhe funksionimin e RrGK të cilat nuk janë në përgjegjësi të organeve tjera të RrGK.

5.4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësi të tij në Bordin Ekzekutiv ose ndonjë organ tjetër udhëheqës të ndërmjetm ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij me përjashtim të përgjegjësi të cilat nuk delegohen sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe paragrafit 2 të Neni 5 të këtij Statuti.

Neni 6

Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

6.1. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.

6.2. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet në mbledhjet e rregullta të anëtarësisë. Çështja dhe/apo ndryshimi i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Anëtarëve do të përcaktohen me rregulloren e punës së RrGK-së.

6.3. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet (nga gjysma e anëtarëve) ose nga Bordi Ekzekutiv. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Kryesuesit/es të Kuvendit të Anëtarëve i/e cili/a do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat të shpjeguara në paragrafin vijues.

6.4. Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për mbledhjen do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku shtatë (7) ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

6.5. Për mbajtjen e MPV dhe/ose MPJ është e nevojshme pjesëmarrja e 50% + 1 e anëtarëve. Nëse ky kuorum nuk arrihet në tentimin e parë, takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.

6.6. Secili/a anëtar/e i/e organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.

6.7. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me dy të tretat (2/3) e anëtarëve.

6.8. Asnjë anëtar/je të Kuvendit të Anëtarëve nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai/a jo ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar/ja i/e Kuvendit të Anëtarëve konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/a jo, ose cilido anëtar i familjes së tij/saj ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

Neni 7

Bordi Ekzekutiv

7.1. Bazuar në përgjegjësitë e dhëna me këtë statut, organi udhëheqës i ndërmjetëm, Bordi Ekzekutiv, duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.

7.2. Bordi do të ketë këto përgjegjësi:

- Përfaqëson RrGK në raport me palë të treta dhe vepron në emër të tij;

- Është përgjegjës që e gjithë veprimtaria e RrGK të kryhet në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi në Kosovë;
- Ndhmon Drejtoreshën Ekzekutive në sigurimin e fondeve për veprimtarinë e RrGK;
- Pranon dhe miraton planet dhe raportet tremujore të punës së RrGK;
- Përgatit seancat e Kuvendit të RrGK;
- Merr vendime financiare dhe udhëheq pasurinë e shoqatës;
- Përgatit propozimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit, të cilat ia parashtron Kuvendit për aprovim;
- Nxjerrë aktet e tjera të RrGK, përveq Statutit;
- Mund të propozojë përfaqësuesin e autorizuar të RrGK-së
- Shqyrton dhe miraton pranimin e anëtarëve në RrGK;
- Vendosë dhe sugjeron për bashkëpunimin dhe lidhjen me shoqata e institucione të tjera;
- Formon komisione të përhershme dhe grupe punuese të RrGK;
- Është përgjegjës për informimin e anëtarëve dhe opinionit për punën dhe aktivitetet e RrGK;
- Kryen dhe punë të tjera, sipas urdhërave dhe udhëzimeve të Kuvendit të RrGK.

7.3. Bordi Ekzekutiv zgjedhet nga Kuvendi i Anëtarëve. Ata/ato do të zgjidhen individualisht me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm në Kuvend. Mënyra e zgjedhjes dhe rregullat e punës së anëtarëve të Bordit përcaktohen me rregullore të veçantë për punën e Bordit, e cila aprovohet nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë votash.

7.4. Bordi Ekzekutiv do të ketë të paktën tre (3) anëtarë, njëri nga të cilët duhet të zgjedhet si Kryesues/e i/e Bordit. Në rast të numrit më të madh të anëtarëve, Bordi gjithmonë duhet të ketë numër tek të anëtarëve. Kryesuesi/ja zgjedhet në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe do të ushtrojë detyrën deri në zgjedhjen e kryesuesit/es së ri/e, me mundësi për rikandidim dhe rizgjedhje.

7.5. Bordi Ekzekutiv nuk mund të ketë dy (2) përfaqësues/e të të njejtës shoqatë për shkak të konfliktit të interesit.

7.6. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv mund të zgjedhen për dy (2) mandate të njëpasnjëshme. Për tu rikandiduar duhet të pauzojnë një (1) vit.

7.7. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të Kuvendit të Anëtarëve.

7.8. Anëtari i Bordit mund të shkarkohet nga detyra, nëse:

- Nuk merr pjesë në tre mbledhje me radhë të Bordit brenda një viti kalendarik;
- Kryen shkelje të rënda të Statutit të RrGK ose të rregulloreve të brendshme të shoqatës;
- Bën dëm material ose moral për RrGK.

7.9. Mandati i anëtarit të Bordit pushon:

- në rast të vdekjes;
- dorëheqjes; ose
- shkarkimit nga Kuvendi i Anëtarëve.

7.10. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Bordit, Kuvendi i Anëtarëve, në afat prej 60 ditësh duhet të zgjedhë pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur / me mandat të ri.

7.11. Vendimet në Bordin Ekzekutiv merren me shumicë votash të anëtarëve prezentë.

7.12. Votimi për çështje të rëndësishme duhet të jetë me shkrim. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv kanë afat prej 48 orëve të deklarohen. Në rast të heshtjes nëpunësit e organizatës e marrin si aprovim heshtjen. Deklarimi me shkrim mund të bëhet më vonë kur merren parasysht rrethanat e jashtëzakonshme (si sëmundja, udhëtimi, ndonjë fatkeqësi etj.).

7.13. Bordi Ekzekutiv mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit.

7.14. Puna e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv është punë vullnetare. Pagesa ose kompenzimi i arsyeshëm për punën e kryer për organizatën do të përcaktohet me rregulloren e veçantë për punën e Bordit Ekzekutiv.

7.15. Asnjë anëtar/eje të Bordit nuk i lejohe të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai/aajo ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtari/ja i/e Bordit konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/aajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

Neni 8

Zyrtarët dhe Nëpunësit

8.1. Në rast nevojë RrGK punëson persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. Drejtori/ja ekzekutiv/e zgjedhet/emërohet nga Kuvendi i Anëtarëve.

8.2. Zyrtarët duhet të punësohen në përputhje me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës, të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarit, si dhe obligimet dhe përkrahimin e punës dhe përgjegjësi të Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për organizatë.

Neni 9

Shpërbërja e organizatës

9.1. Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve.

9.2. Kur të vendosë për shpërbëjen e organizatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jenë paguar borxhet e organizatës. Shoqata (t) ose fondacioni (et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njejta ose të ngjajshme sikurse organizata.

Neni 10

Ndryshimet e statutit

10.1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave (2/3) e anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 11

Periudhat e raportimit dhe viti financiar

11.1. Bordi Ekzekutiv dhe Zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.

11.2. Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

Ky statut është aprovuar nga Kuvendi i Anëtarëve të RrGK në Prishtinë me 1 korrik 2017.

